

Nr. 01/14

Datë: 05.06.2014

Prishtinë

Në mbështetje të nenit 9, pika 2 të Statutit të Fakultetit të Studimeve Islame, në mbështetje të propozimit të Komisioni të formuar nga KMSH-ja për hartimin e rregullores për zgjedhjen e anëtarëve të KMSH-së dhe Dekanit të FSI-së, si dhe në mbështetje të miratimit të Kryesisë së BIRK-ut, aprovohet:

Rregullorja për zgjedhjen e anëtarëve të KMSH-së dhe Dekanit të FSI-së

Zgjedhja e anëtarëve të KMSH-së

Neni 1

Zgjedhjet për organet udhëheqëse të FSI-së i shpallë Këshilli Mësimor Shkencor i fakultetit në afat të paraparë sipas statutit të FSI-së.(Neni 14, paragrafi 4).

Neni 2

Mbledhjen e rregullt të stafit mësimdhënës e fton dekani i FSI-së.

Neni 3

Në këtë mbledhje bëhet zgjedhja e anëtarëve të KMSH-së për mandatin e ri (neni 8, paragrafi 2 i statutit të FSI-së).

Neni 4

Mbledhjen e udhëheq dekani aktual, i cili kërkon nga të pranishmit në mbledhje që të propozojnë kandidatët për komisionin e numërimit të votave, i cili përbëhet prej 3 anëtarëve.

Neni 5

KMSH-në e përbëjnë mësimdhënësit, bashkëpunëtorët, asistentët, përfaqësuesi i BIK-së, sekretari i fakultetit dhe përfaqësuesi i studentëve të rregullt, (të zbatohet neni 8 i statutit të FSI-së).

Neni 6

Anëtarët e KMSH-së të fakultetit nga radhët e profesorëve do të zgjedhën nga profesorët në marrëdhënie të rregullt pune dhe nga bashkëpunëtorët.

Neni 7

I njëjti person nuk mund të votohet as të votoj nga dy pozita pune që mund t'i ketë në fakultet.

Neni 8

Në rastet kur dy ose më shumë kandidat kanë marrë numrin e njëjtë të votave për një numër joadekuat të mandateve në dispozicion, duhet të organizohet rivotimi i dytë, nëse përsëritet numri i njëjtë i votave edhe në votimin e dytë, atëherë bëhet hedhja e shortit nga ana e Komisionit për numërimin e votave, që do të vendosë për ndarjen përfundimtare të mandateve.

Neni 9

Të qenit anëtarë i ndonjë komisioni të ndërlidhur me procesin zgjedhor, nuk është pengesë për të qenë kandidat për ndonjë pozitë në zgjedhje.

Neni 10

Secili votues ka të drejtë të shënoj aq kandidat sa edhe ka mandate në konkurrim në zgjedhjet e caktuara, në të kundërtën, fletëvotimet janë jo-valide kur shënohen më shumë kandidat se sa maksimumi i përcaktuar. Kjo vlen edhe për kandidatët e propozuar për anëtarë të KMSH-së edhe për kandidatët e propozuar për postin e Dekanit.

Neni 11

KMSH i fakultetit në mbledhjen e parë bënë verifikimin e mandateve të anëtarëve të KMSH-së, në bazë të raportit të sekretarit të fakultetit për rregullsinë e zgjedhjeve të anëtarëve të KMSH-së.

Zgjedhja e kryesuesit të përkohshëm të KMSH-së

Neni 12

Kryesuesi i përkohshëm i KMSH-së, zgjidhet nga kandidatët e propozuar të KMSH-së me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të KMSH-së të fakultetit.

Neni 13

Nëse asnjë nga kandidatët e propozuar nuk e merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, atëherë organizohet radha e dytë e votimit vetëm për kandidatin me numër më të madh të votave. Nëse kandidati nuk merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të

anëtarëve, në radhën e dytë, konsiderohet se kandidati është refuzuar dhe KMSH i fakultetit është i obliguar të propozoj kandidat tjerë.

Neni 14

Në rast të votave të barabarta, votimi përsëritet, dhe nuk veprohet si në rastin e mandateve për anëtar të KMSH-së.

Neni 15

Kryesuesi i përkohshëm i KMSH-së udhëheqë mbledhjet e KMSH-së deri në zgjedhjen e Dekanit të ri.

Vendimmarrja-votimi dhe zgjedhja

Neni 16

KMSH vendimet i merr me shumicën e votave të numrit të gjithëmbarshtëm të anëtarëve të KMSH-së (neni 9, pika 11 i statutit të FSI-së)

Neni 17

Votimi bëhet me vota të fshehta, apo me aklamacion duke e ngritur dorën. Votimi bëhet “për”, “kundër” dhe “apstenim”.

Neni 18

Procedurën e votimit të fshehtë e zbaton komisioni i emëruar nga KMSH i përbërë prej tre anëtarëve. Numërimi i votave nga anëtarët e komisionit bëhet nën mbikëqyrjen e sekretarit të fakultetit.

Neni 19

Votimi me vota të fshehta bëhet për: propozimin e kandidatëve për dekan, për zgjedhjen e kryesuesit të përkohshëm të KMSH-së, për çështjet që prekin intimitetin e ndonjërit nga anëtarët e KMSH-së dhe për çështjet kur kryesuesi kërkon votim të fshehtë.

Zgjedhja e Dekanit

Neni 20

KMSH-ja shpall konkurs për Dekan konform Statutit të FSI-së

Neni 21

Çdo anëtarë i KMSH-së të Fakultetit, i cili i plotëson kushtet sipas Statutit ka të drejtë të kandidojë për pozitën e Dekanit.

Konkursi për Dekan ngel i hapur 8 (tetë) ditë.

Kandidaturat e arritura me kohë i shqyrton KMSH-ja dhe zgjedhjen e dy kandidatëve të mundshëm për dekan nga ma shumë të paraqitur, e bënë me votim të fshehtë.

Në listën e kandidatëve të mundshëm për dekan votohet vetëm një emër.

Dy kandidatët që marrin më së shumti vota i dërgohen Kryesisë për vendosje dhe miratim.

Neni 22

Dekan i zgjedhur konsiderohet kandidatit të cilin e emëron Kryesia me Vendim.

Neni 23

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kryesia e BIRK-ut.

Vërteton:

Prof. dr. Qazim Qazimi, dekan